

Republika e Kosovës - Republika Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšta Administrativne Poslove

01
Nr./Br. 011/P/1-11133
Data/Datum 01.06.2020
Gjakovë-Djakovica-Gjakova

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës - Gjakovë
01 Nr. _____/2020
Dt. 28.05.2020

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 12 Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 18 të Statutit të Komunës së Gjakovës, Nenin 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 Për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së pa Luajtshme Komunale, në mbledhjen e mbajtur me datë 28.05.2020 pas diskutimit lidhur me pikën e 8 të rendit të ditës: Propozim Vendimi për formimin e komisionit vlerësues për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale-Tregu në Rogovë, e miratoi këtë:

V E N D I M

1.Themelohet Komisioni Vlerësues për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale, Tregu në Rogovë për të cilat është nxjerrë vendimi paraprak, me këtë përbërje :

1. znj. Saranda Hyseni , përfaqësuese e Ekzekutivit të Komunës .
2. z. Durim Halilaj, përfaqësues i Ekzekutivit të Komunës .
3. z. Fazli Hoxha, përfaqësues i Kuvendit të Komunës .
4. znj. Mimoza Shala, përfaqësuese e Kuvendit të Komunës .
5. znj. Nora Kulludra, përfaqësuese e sektorit jo qeveritar .

2.Komisioni Vlerësues për Dhënie në Shfrytëzim Afatshkurtër të Pronës Komunale ka për detyrë dhe përgjegjësi që ti zhvilloj procedurat e parapara me Ligjin Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së paluajtshme Komunale vetëm për pronat e cekura në pikën 1 të këtij vendimi, për të cilat është nxjerrë vendimi paraprak nga Kuvendi i Komunës.

3.Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës

4.Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës z. Ardian Gjini
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Anëtarëve të Komisionit
- Shërbimit profesional të Kuvendit të Komunës .
- Arkivit,



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
z. Anton Shala